

## Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë

Ky dokument është rezultat i konferencës “Roli i shkencave shoqërore në shoqëritë në tranzicion, me theks të veçantë në Kosovë”, mbajtur në Departamentin e Shkencës Politike, në Universitetin e Prishtinës (UP) më 5 tetor 2012. Konferenca, e organizuar nga Qendra për Kurajo Politike (Centre for Political Courage) dhe e përkrahur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në kuadër të Programit për Promovimin e Hulumtimeve Rajonale në Ballkanin Perëndimor (PPHR), shërbeu si platformë konstruktive për rreth 50 profesorë universitarë, hulumtues vendor e ndërkombëtarë, studentë, për të shkëmbyer pikëpamjet dhe përvojat e tyre sa i përket hulumtimeve për shkencat shoqërore në Kosovë. Në përputhje me këtë, konferenca synoi edhe të identifikojë praktikatat më të mira për forcimin e kapaciteteve hulumtuese edhe të rrisë bashkëpunimin mes bartësve të arsimit të lartë publik dhe privat, si dhe organizatave think tank në Kosovë. Pjesët në vijim paraqesin çështjet dhe sfidat e adresuara gjatë konferencës.

## Gjendja e hulumtimeve në Universitetin e Prishtinës

UP-ja përballlet me sfida të shumta duke përfshirë mungesën e financimit, kapacitetet joadekuate për hulumtime, qendra të pakta për hulumtime, struktura joefektive të qeverisjes, koleksione të pamjaftueshme dhe të vjetruara të librave dhe revistave në bibliotekat universitare, numër të kufizuar të publikimeve shkencore dhe mungesë të lloj-llojshmërisë së kurseve si në nivelet bachelor, ashtu edhe studimet master dhe ato të doktoratës, e po ashtu edhe metoda të vjetruara të mësimdhënies. Paralelisht me këtë, ka analiza të pakta lidhur me atë se cilat programe studimi do të ishin relevante dhe do të kontribuonin në mënyrë domethënëse në ndryshimet shoqërore, ekonomike e politike.

### Cilat janë problemet kryesore?

- Nuk ekziston asnjë ndërlidhje mes mësimdhënies dhe hulumtimeve të fundit shkencore.
- Universiteti është i ekspozuar minimalisht ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar, përvojave dhe ekspertizës së re.
- Ka mungesë të bashkërendimit ndër-institucional në lehtësimin e aplikimit për fonde ndërkombëtare. As Fakultetet dhe Departamentet nuk zhvillojnë programe, projekte apo aplikacione për grante të përbashkëta.
- UP-ja ka mungesë të kapaciteteve të nevojshme njerëzore për të aplikuar për projekte ndërkombëtare dhe për të thithur fondet ndërkombëtare.
- Hulumtimet janë sporadike, të pakoordinuara dhe në baza individuale, e jo institucionale.
- Nuk ka hulumtime aplikative në shkencat shoqërore që do të kontribuonin në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike.
- UP-ja ka mungesë të buxhetit dhe nismave që përkrahin hulumtimet dhe programet e reja të MA dhe PhD.
- Ka nivel të ulët të mobilitetit (p.sh. kufizime në udhëtime për shkak të regjimit kufizues të vizave dhe mungesës së fondeve) në mesin e stafit akademik dhe studentëve.
- Nuk ka kurrfarë zbatimi të Axhendës së Lisbonës, Procesit të Bolonjës dhe Strategjisë Evropiane 2020, sipas së cilave ndërmarrësia, inovacionet dhe hulumtimet do të duhet të ishin të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën.
- Ka mungesë të instituteve për hulumtime dhe partneriteteve me universitetet dhe institucionet tjera akademike në rajon.

## Gjendja e hulumtimeve tek bartësit privat të arsimit të lartë

Institucionet private të arsimit të lartë u shfaqën për herë të parë në Kosovë më 2004. Aktualisht ekzistojnë 17 kolegje të akredituara private dhe 4 shkolla të larta private, por nuk ka asnjë universitet privat ashtu siç përkufizohet me Ligjin për Arsimin e Lartë të vitit 2011. Ka analiza të pakta lidhur me atë se çfarë programe studimi do të ishin relevante dhe do të kontribuonin në mënyrë

domethënëse në ndryshimet shoqërore e ekonomike. Cilësia e hulumtimeve të ndërmarrura në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë është e varfër.

### Cilat janë problemet kryesore?

- Ka mungesë të politikave adekuate për promovimin e zhvillimit të kapaciteteve vetanake për hulumtime. Me përjashtim të disa kolegjeve private, siç është Kolegji Riinvest, shumica e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë nuk ndajnë fonde për hulumtime.

## Gjendja e hulumtimeve në sektorin e shoqërisë civile

Shoqëria civile kryesisht identifikohet me Organizatat Jo-Qeveritare. Organizatat think tank, të cilat vetëm së voni kanë dalë në sferën publike, janë të orientuara drejt ofrimit të ekspertizës alternative për politikën qeveritare. Edhe pse numri i organizatave të shoqërisë civile të regjistruara që nga viti 1999 ka arritur në 5000, vetëm një numër shumë i vogël faktikisht kryejnë hulumtime. Për më tepër, kapacitetet për hulumtime të organizatave think tank në Kosovë janë të kufizuara dhe cilësia e rezultateve të hulumtimeve mbetet më e ulët se në shtetet tjera të Evropës Jug-lindore, apo në shtetet e Bashkimit Evropian.

### Cilat janë problemet kryesore?

- Ka mungesë të njohurive mbi atë se çfarë janë organizatat think tank, si funksionojnë ato dhe çfarë produktesh (intelektuale, analitike, hulumtuese, avokuese, e politike) krijojnë ato.
- Për shkak të rënies së cilësisë së arsimit të lartë në përgjithësi, niveli i analizës dhe hulumtimeve në organizatat think tank është i ulët.
- Cilësia e hulumtimeve në sektorin organizatave think tank shpesh është mbi nivelin mesatar të realizuar nga institucionet e arsimit të lartë privat dhe publik.
- Ka mungesë të bashkëpunimit mes organizatave think tank, universiteteve publike dhe bartësve privat të arsimit të lartë.
- Ka mungesë ndërveprimi në mesin e organizatave think tank, mediave dhe institucioneve publike sa i përket hulumtimeve dhe çështjeve shkencore.
- Edhe pse janë të regjistruara më shumë se 5000 organizata jo-qeveritare, vetëm një numër i vogël i tyre mund të klasifikohet si organizata think tank të orientuara drejt hulumtimeve. Për më tepër, vetëm shtatë organizata think tank janë funksionale.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Agron Demi, "Research and analysis in the context of think tank organizations in Kosovo and the need for deeper cooperation between universities and think tanks", GAP Institute, 2012. Sipas Agron Demit, Drejtor Ekzekutiv në Institutin GAP, këto në vijim janë institutet për politika në Kosovë: Instituti Riinvest, KIPRED, INDEP, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Qendra për Studime të Sigurisë në Kosovë dhe D4D.

- Vetëm një numër minimal i njerëzve në Kosovë punojnë si hulumtues.<sup>2</sup>
- Edhe pse shumica e hulumtuesëve në Kosovë e kanë përfunduar arsimimin e tyre jashtë vendit, numri i hulumtuesëve me gradën PhD është shumë i ulët; vetëm 2 hulumtues me PhD janë të përfshirë në organizatat think tank.<sup>3</sup>
- Asnjë organizatë think tank në Kosovë nuk renditet në mesin e tridhjetë instituteve të tilla më të mira në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në Evropë në përgjithësi.<sup>4</sup>
- Organizatat think tank janë të kufizuara në aplikimin e metodave kuantitative, për dy arsye: së pari, vlera e tyre nuk kuptohet apo vlerësohet, dhe së dyti, ka mungesë të kapaciteteve financiare dhe njerëzore për të realizuar hulumtime të tilla.<sup>5</sup>
- Organizatat think tank në masë të madhe janë të orientuara kah donatorët dhe si rezultat në masën që ato kryejnë hulumtime, janë të prira që të punojnë në tema të ngjashme dhe kryesisht e riprodhojnë punën e njëra-tjetrës.
- Të formalizohen mekanizmat e dialogut dhe këmbimit të informatave me komunitetin akademik, institucionet për hulumtime shkencore, institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, si dhe organizatat think tank që të informohen lidhur me fondet e ndara nga MASHT, dhe programet financuese, siç janë: Programi FP7, Evropa 2020 dhe Horizonti 2020.
- Të mundësohet një dialog i përhershëm mes elitave politike, komunitetit akademik, mediave, sektorit të OJQ-ve dhe publikut më të gjerë për rëndësinë e investimeve në hulumtimet shkencore.

#### Për Universitetin e Prishtinës:

- Të zhvillohen programe MA dhe PhD të bazuara në hulumtime dhe konferenca tematike shkencore.
- Të investohet në infrastrukturën dhe trajnimet për hulumtime dhe ato të vihen në dispozicion për stafin mësimdhënës dhe studentët, p.sh. programet softuerike statistikore dhe qasja në bibliotekat elektronike, e po ashtu edhe rritja e kapaciteteve llogaritëse, si dhe trajnimet për përpilimin dhe analizimin e hulumtimeve.
- Të zvogëlohen orët e mësimdhënies për asistentët nga 10 në 6 në mënyrë që t'u jepet kohë për hulumtime dhe zhvillim të mëtejshëm akademik.
- Të rekrutohen kandidatët për PhD që janë duke studiuar jashtë vendit dhe ata që kanë treguar rezultate të shkëlqyera gjatë studimeve të tyre në UP.
- Të zgjerohet infrastruktura aktuale fizike. Aktualisht hapësira është e pamjaftueshme dhe ka anëtarë të stafit akademik që nuk kanë zyrë për të punuar.
- Të nxitet dhe stimulohet stafi akademik për të publikuar në revistat e huaja akademike që janë të njohura ndërkombëtarisht dhe që kanë ndikim në fushat e tyre.
- Të respektohen më rreptë kriteret e përzgjedhjes së stafit akademik. Emërimet dhe promovimi duhet të bëhen jo vetëm në bazë të sasisë, por edhe në bazë të cilësisë së hulumtimeve të realizuara.
- Të themelohet dhe mbështetet financiarisht publikimi i revistave akademike në Fakultetin Filozofik, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Juridik.

## Rekomandimet

### Për Kuvendin e Kosovës:

- Ta miratojë Ligjin për Hulumtime dhe Aktivitete Shkencore në Kosovë. Sipas draft ligjit ekzistues, Kosova do të ndante 0.7% të buxhetit të saj për shkencë, që do të nënkuptonte një vlerë prej rreth 11 milionë euro në vit për hulumtime shkencore, ndërsa objektivi i shteteve anëtare të BE-së për hulumtime dhe shkencë është 3% e Bruto Produktit Vendor (BPV).<sup>6</sup>

### Për Qeverinë e Kosovës:

- Të rritet ndjeshëm investimi në shkencë dhe hulumtime. Përqindja e BPV për hulumtime shkencore dhe inovacione në Kosovë duhet të rritet në 0.03% të BPV në 2014. Kosova aktualisht ndan 0.01% të BPV për hulumtime shkencore, derisa ndarja mesatare e BPV për hulumtime shkencore në 27 shtetet anëtare të BE-së është 1.85%, pothuajse 200 herë më e lartë. Ky investim në shkencë dhe hulumtime do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe rritjen e eksporteve në Kosovë.

### Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjinë së Kosovës:

- Të ndahen fonde të mjaftueshme për zbatimin efektiv të Programit Kombëtar të Shkencës. Nevojat e planifikuara financiare për zbatimin e Programit Kombëtar të Shkencës gjatë vitit 2012 kanë qenë 3.4 milionë euro, ndërsa Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjinë së Kosovës (MASHT) ka ndarë vetëm 48 mijë euro për zbatimin e programit.

2 Nga 208,454 të punësuar, vetëm 141 prej tyre punojnë në sektorin e hulumtimeve, apo përafërsisht 0.05% e të punësuarve. Axhensia për Statistika e Kosovës, 'Kosovo Population and Housing Census 2011: Main Data', 2012.

3 Agron Demi, "Research and analysis in the context of think tank organizations in Kosovo and the need for deeper cooperation between universities and think tanks", GAP Institute, 2012.

4 James G. McGann, "2011 Global Go To Think Tanks Report and Policy Advice", Think Tank and Civil Societies Program – University of Pennsylvania USA. Në dispozicion në [http://www.gotothinktank.com/wp-content/uploads/2012/09/2011-Global-Go-To-Think-Tanks-Report\\_FINAL-VERSION.pdf](http://www.gotothinktank.com/wp-content/uploads/2012/09/2011-Global-Go-To-Think-Tanks-Report_FINAL-VERSION.pdf) (Qasur më 13 nëntor 2012)

5 Florian Qehaja, "The role of think tanks as an alternative expertise in Kosovo: data collection, methodological development and ethics", KCSS, 2012.

6 Për më tepër shiko, Programin e Shtatë Kornizë për Hulumtime, Zhvillim Teknologjik dhe Demonstrim, 2007–2013. Në dispozicion në [http://ec.europa.eu/europe2020/reaching-the-goals/targets/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europe2020/reaching-the-goals/targets/index_en.htm) (Qasur më 13 nëntor 2012)

- Të ndërtohen partneritete strategjike me universitet dhe institutet për hulumtime në rajon dhe Evropë për zhvillimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta MA dhe PhD të bazuara në hulumtime.
- Të themelohet programe për mobilitet të stafit akademik dhe studentëve, si dhe të shfrytëzohen programe si TEMPUS për zhvillimin e kurrikulave ose CEEPUS për mobilitet.
- Të themelohet një zyrë e veçantë për të përkrahur koordinimin ndër-institucional mes fakulteteve dhe departamenteve dhe me kapacitete të mjaftueshme për të përkrahur aplikimin për dhe thithjen e fondeve të BE-së, siç është korniza e ardhshme financiare për hulumtime shkencore "Horizonti 2020".
- Të rekrutohet staf akademik i mjaftueshëm për të zbatuar Axhendën e Lisbonës, Procesin e Bolonjës dhe Strategjinë Evropiane 2020 ku ndërmarrësia, inovacioni dhe hulumtimet janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

#### Për bartësit privat të arsimit të lartë:

- Të rritet konkurrenca dhe të zhvillohen programe BA dhe MA në shkencat shoqërore për të plotësuar, dhe jo vetëm për të përsëritur programet ekzistuese BA dhe MA në universitetet publike.
- Të themelohen revista akademike në shkencat shoqërore dhe të ndahen fonde për kryerje të hulumtimeve në institucionet përkatëse.

#### Për organizatat think tank:

- Të rritet niveli i cilësisë së analizës dhe hulumtimeve në nivelin e organizatave think tank kudo në rajon.

- Të rritet bashkëpunimi mes organizatave think tank, universiteteve publike dhe bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë.
- Të rritet vetëdija publike përmes vendosjes së pranisë më të fuqishme në media, apo përmes fushatave të synuara rreth asaj se çfarë janë organizatat think tank, cili është profili i tyre, dhe ç'loj të studimeve hulumtuese ofrojnë ato.
- Të punësohen më shumë hulumtues me gradën MA dhe në veçanti të tillë me PhD, pasi që numri total i personave që punojnë në sektorin e hulumtimeve është vetëm 0.05% e popullsisë së punësuar.
- Të krijohet mjedis më pozitiv komunikues mes organizatave think tank, universitetit publik dhe institucioneve vendim-marrëse në Kosovë, në mënyrë që të gjeturat e hulumtimeve të këtyre organizatave të kenë ndikim më të madh për zhvillimin e politikave publike të mirë-informuara.

#### Për donatorët ndërkombëtarë:

- Të përkrahet zhvillimi institucional, zhvillimi i politikave dhe zhvillimi i shkencave shoqërore në përgjithësi.
- Të përkrahen programet e përbashkëta të studimeve për MA dhe PhD mes UP-së dhe universiteteve jashtë vendit.
- Të përkrahet UP-ja dhe bartësit privat të arsimit të lartë në Kosovë për të forcuar kapacitetet e tyre në hartimin dhe metodologjinë e projekteve dhe për të thithur fonde nga korniza e ardhshme financiare 'Horizonti 2020'.

Kontakti: Njësia Koordinuese Vendore në Kosovë

Qendra për Kurajo Politike (Centre for Political Courage)

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Filozofisë, Departamenti i Shkencës Politike, Dhoma 215

Rr. Nënë Tereza., p.n. 10000, Prishtinë, Kosovë

Telefoni: +386 49 100 350

kosovo@rrpp-westernbalkans.net